



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0095

Paneli Shqyrtues, i emëruar në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga panelisti individual Isa Hasani, duke vendosur sipas ankesës së OE " EKO - ELECTRONICS " SH.P.K., kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me Material Metalik - Ritender I” me numër të prokurimit 214/30400-25-11090-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS, më 06/03/2026, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE " EKO - ELECTRONICS " SH.P.K., me nr. 2026/0095, me datën, 13.02.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me Material Metalik - Ritender I” me numër të prokurimit: "214/30400-25-11090-1-2-1", inicuar nga autoriteti kontraktues, Policia e Kosovës.
2. Mbetet në fuqi, Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, - Policia e Kosovës, datës 29.01.2026, për anulimin e aktivitetit prokurimit “Furnizim me Material Metalik - Ritender I” me numër të prokurimit: "214/30400-25-11090-1-2-1".
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Bazuar në nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues OE " EKO - ELECTRONICS " SH.P.K., i kthehet tarifa e sigurimit të ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për tërheqje të tarifës për sigurim të ankesës, në të kundërtën bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me date 11.12.2025 POLICIA E KOSOVËS, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me Material Metalik - Ritender I” me numër të prokurimit 214/30400-25-11090-1-2-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur , lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 59,114.50 €.

Me date 29.01.2026, POLICIA E KOSOVËS, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 ku është anuluar aktiviteti i prokurimit.

Me 31.01.2026 OE " EKO - ELECTRONICS " SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Autoriteti Kontraktues me dt 04.02.2026 e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim si te pa bazuar.

OSHP me dt 13.02.2026 ka pranuar ankesën nga OE " EKO - ELECTRONICS " SH.P.K., me nr. 0095/2026 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me Material Metalik - Ritender I” me numër të prokurimit 214/30400-25-11090-1-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues " EKO - ELECTRONICS " SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

ANKESË

Operatori Ekonomik: EKO-ELECTRONICS SH.P.K.

Autoriteti Kontraktues: Policia e Kosovës

Aktiviteti i Prokurimit: “Furnizim me Material Metalik – Ritender”

Nr. i Prokurimit: 214/30400-25-11090-1-2-1

Drejtuar: Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) – Prishtinë

I. OBJEKTI I ANKESËS

Operatori Ekonomik (OE) EKO-ELECTRONICS SH.P.K. paraqet këtë ankesë kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues (AK) mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, të datës 04.02.2026, me të cilin OE është eliminuar padrejtësisht për:

Pjesa A: Pozicionet 18, 19, 24, 25, 26, 27, 28

Pjesa B: Pozicionet 6, 12, 13

Pjesa C: Pozicioni 3 – Set koke kaçavide L25 mm, 32 pjesë

II. SHKELJA PROCEDURALE: Dështimi i AK-së për rishqyrtim meritore

Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 108/A (pika 10) të LPP-së. AK nuk ka shqyrtuar në mënyrë meritore pretendimet tona ankimore të dorëzuara më datë 30.01.2026, por thjesht ka përsëritur arsyetimin e eliminimit fillestar.

AK ka dështuar të argumentojë pse pretendimet tona janë të pabazuara, duke e bërë procesin e rishqyrtimit formal dhe jo substancial.

III. ARGUMENTIMI I SHKELJEVE MATERIALE

1. “Fotografia e paketimit” – kriter i paparaparë në Dosjen e Tenderit (DT)

AK pretendon se nuk kemi ofruar fotografi të paketimit (kutisë).

Fakti: DT ka kërkuar “Katalog/Broshurë me përshkrim të detajuar”. Ne kemi ofruar katalogun ku specifikohet qartë “Kuti 100 copë”.

Shkelja: Kërkesa për fotografi specifike të kutisë përbën shtim kriteri pas hapjes së ofertave.

Paketimi është aspekt tregtar/logjistik dhe nuk ndikon në përputhshmërinë teknike të produktit.

Paketimi nuk përbën specifikë teknike.

Përshkrimi në ofertë përbën zotim ligjor.

Me këtë veprim, AK ka shkelur nenin 7 dhe nenin 59 të LPP-së, duke interpretuar specifikimet jashtë asaj që është shpallur në DT.

2. Pozicioni 6 (Pjesa B) – Pasaktësi formale (Hugo vs. Yato)

Argumenti: Mospërputhja e emrit të prodhuesit përbën pasaktësi grafike/formale, e cila nuk ndikon në parametrat teknikë të produktit.

Detyrimi i AK-së: Sipas nenit 72 të LPP-së, AK ishte i obliguar të kërkonte sqarim për këtë mospërputhje formale para se të merrte vendim për eliminim.

AK ka zgjedhur eliminimin e ofertës më të lirë për një gabim shkrimi, duke dëmtuar parimin e ekonomikitetit (neni 1 i LPP-së).

3. Interpretim arbitrar i “Set 32 pjesë” (Pozicioni 3, Pjesa C)

Fakti: DT kërkon “Set koke kaçavide... 32 pjesë”. Seti i ofruar nga ne përmban 32 pjesë totale (koka dhe aksesorë funksionalë).

Shkelja: AK ka interpretuar se të gjitha 32 pjesët duhet të jenë vetëm “koka”, kriter ky që nuk figuron në DT.

Ky interpretim i ngushtë, i bërë pas hapjes së ofertave, kufizon konkurrencën dhe shkel parimin e proporcionalitetit.

IV. SHKELJET LIGJORE

Me veprimet e tij, Autoriteti Kontraktues ka shkelur:

Nenin 1 (Parimi i ekonomicitetit)

Nenin 7 (Barazia në trajtim)

Nenin 28 (Specifikimet teknike)

Nenin 59 (Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve)

Nenin 72 (Sqarimi i tenderëve)

Nenin 108/A (Rishqyrtimi i vendimeve të AK-së)

V. KËRKESA PËR PANELIN E OSHP-së

Kërkojmë nga Paneli i OSHP-së që:

Të aprovojë ankesën si të bazuar.

Të anulojë vendimin e AK-së për eliminim.

Të urdhërojë AK-në që lëndën ta kthejë në rivlerësim dhe të bëjë vlerësimin konform kriterëve të shpallura në Dosjen e Tenderit, duke aplikuar nenin 72 për çdo paqartësi formale.

Përgjigje ne kerkesen per rishqyrtim: • Lidhur me pretendimin për shkelje të Nenit 1 të LPP-së (Qëllimi)

Autoriteti Kontraktues nuk e ka shkelur Nenin 1 të LPP-së për arsyet në vijim:

Qëllimi i aktivitetit të prokurimit është sigurimi i furnizimeve plotësisht në përputhje me kërkesat e AK-së. Kriteret janë përcaktuar në harmoni me qëllimin e aktivitetit të prokurimit dhe, si rrjedhojë, AK ka siguruar mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike dhe të gjitha fondeve e burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Përmes këtij aktiviteti janë përcaktuar qartë kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomikë, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionarët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen ose marrin pjesë në aktivitete të prokurimit.

Ky ligj ka për qëllim gjithashtu sigurimin e integritetit dhe përgjegjësisë së zyrtarëve publikë, nëpunësve civilë dhe personave të tjerë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, duke kërkuar që vendimet dhe baza ligjore e faktike e tyre të mos ndikohen nga interesa personale, të karakterizohen nga mosdiskriminimi dhe transparenca e lartë, si dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe materiale të ligjit.

AK ka vepruar në harmoni të plotë me LPP-në dhe Rregulloren 001/2022, prandaj pretendimi ankimor është i pabazuar.

- Lidhur me pretendimin për shkelje të Nenit 7 (Barazia në trajtim)

Autoriteti Kontraktues nuk ka bërë shkelje të Nenit 7 të LPP-së.

AK i ka trajtuar të gjithë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese, duke vepruar në mënyrë transparente dhe në përputhje me kërkesat teknike dhe profesionale të Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë.

Të gjitha ofertat e pranuar janë trajtuar dhe vlerësuar në mënyrë të drejtë, pa favorizuar apo diskriminuar asnjë OE pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit.

Sa i përket katalogut/broshurës, është kërkuar që për secilin artikull të ofrohet përshkrim i detajuar, në mënyrë që të mundësohet vlerësimi sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në DT.

Në përshkrimin teknik të artikujve është përfshirë edhe paketimi “kuti 100 copë”. OE për artikujt 18, 19, 24, 25, 26, 27 dhe 28 ka ofruar vetëm fotografi të produktit, por jo dëshmi për paketimin prej 100 copësh sipas përshkrimit teknik dhe sipas prodhuesit me të cilin ka ofertuar.

E njëjta situatë vlen edhe për artikujt 12 dhe 13 të Pjesës B. Për më tepër, te Pjesa B, artikulli 6 figuron me prodhues “Hugo”, ndërsa në listën e çmimeve është dhënë “Yato/Poloni”, duke krijuar mospërputhje në ofertë.

Sa i përket artikullit 3 të Pjesës C, është kërkuar “Set koke kaçavide L25, 32 pjesë”, çka nënkupton se kërkesa i referohet vetëm kokave të kaçavidës dhe jo pjesëve të tjera shtesë.

Vlen të theksohet se katalogu/broshura nuk është kërkuar vetëm për ilustrim, por si dokument për vlerësim teknik. Prandaj, ky pretendim ankimor i OE-së është i pabazuar.

- Lidhur me Nenit 28 – Specifikimet teknike

Autoriteti Kontraktues ka përpiluar specifikimet teknike në përputhje me qëllimin e prokurimit, duke synuar sigurimin e qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar.

AK është i ndaluar të hartojë specifikime që favorizojnë ose diskriminojnë operatorë të caktuar ekonomikë. Policia e Kosovës ka përpiluar të gjitha specifikimet teknike konform nevojave të saj dhe në përputhje me LPP-në, duke respektuar transparencën dhe trajtimin e barabartë.

Në këtë rast, OE ka ofruar fotografi të artikujve me përshkrim të përgatitur nga vetë OE, i cili nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në DT. Prandaj, ky pretendim është i pabazuar.

- Lidhur me Nenit 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve

Autoriteti Kontraktues konsideron një tender të përgjegjshëm vetëm nëse ai është në përputhje me të gjitha kërkesat e parashtruara në Njoftimin për Kontratë, Formularin e Dosjes së Tenderit (FDT) dhe specifikimet teknike të detyrueshme.

AK ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e të gjitha ofertave në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese.

Pretendimi se në specifikimet teknike nuk është kërkuar paketimi për artikujt 18, 19, 24, 25, 26, 27, 28 dhe 12, 13 nuk qëndron, pasi paketimi “kuti 100 copë” është pjesë e përshkrimit teknik.

OE për këta artikuj ka ofruar vetëm fotografi dhe jo dëshmi për paketimin sipas kërkesës. Po ashtu, për artikullin 6 të Pjesës B ekziston mospërputhje ndërmjet prodhuesit të deklaruar në dokumentacion dhe atij të paraqitur në listën e çmimeve.

Sa i përket artikullit 3 të Pjesës C, kërkesa ka qenë e qartë për “Set koke kaçavide L25, 32 pjesë”, që nënkupton vetëm koka kaçavide.

Katalogu/broshura nuk është kërkuar vetëm për ilustrim, por për qëllim të vlerësimit teknik. Prandaj, pretendimi ankimor është i pabazuar.

- Lidhur me Nenit 72 – Sqarimi i tenderëve

Autoriteti Kontraktues ka bërë vlerësim të drejtë dhe të barabartë të të gjitha ofertave të pranuar.

Duke qenë se dokumentacioni i dorëzuar nga OE ka qenë i mjaftueshëm për të konstatuar mospërputhjet me kërkesat e DT-së, AK nuk e ka parë të nevojshme kërkimin e sqarimeve shtesë.

Prandaj, edhe ky pretendim i OE-së është i pabazuar.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtrësat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 13.02.2026 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2026/0095, ndërsa me datë 07.12.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0095, me rekomandimet si në vijim :Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK është pajtuar rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Lidhur me pretendimet e " EKO - ELECTRONICS " SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0095 ka vlerësuar si në vijim:

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

Eksperti shqyrtues ka analizuar në tërësi dhe me kujdes të gjitha pretendimet e paraqitura nga operatori ekonomik ankues në ankesën e tij. Për qëllime të qartësisë, koherencës dhe për të shmangur përsëritjet e panevojshme, pretendimet ankimore në këtë raport paraqiten në formë të përmbledhur, duke ruajtur thelbin e secilit pretendim ashtu siç është ngritur nga ankuesi. Pas pretendimit të përmbledhur, jepet përgjigjja përkatëse e ekspertit.

Pretendimi i përmbledhur ankimor

Operatori Ekonomik (OE) EKO-ELECTRONICS SH.P.K. ka paraqitur ankesë kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues mbi Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, datë 04.02.2026, me të cilin është eliminuar nga procedura e prokurimit për pozicionet në kuadër të Pjesës A (Poz. 18, 19, 24, 25, 26, 27, 28), Pjesës B (Poz. 6, 12, 13) dhe Pjesës C (Poz. 3 – Set koke kaçavide L25 mm, 32 pjesë).

OE ankues pretendon se Autoriteti Kontraktues nuk ka bërë shqyrtim meritore të kërkesës për rishqyrtim, në kundërshtim me nenin 108/A të LPP-së, duke përsëritur arsyetimin e eliminimit fillestar pa trajtuar në mënyrë të argumentuar pretendimet e paraqitura nga ana e OE-së.

Sa i përket aspektit material, OE ankues pretendon se eliminimi i tij është bërë mbi bazë të kërkesave që nuk kanë qenë të përcaktuara në Dosjen e Tenderit, përkatësisht për shkak të mungesës së fotografive të paketimit të produkteve, ndonëse në DT është kërkuar vetëm dorëzimi i katalogut/broshurës me përshkrim të detajuar.

Gjithashtu, OE ankues pretendon se për pozicionin 6 mospërputhja në emërtimin e prodhuesit përbën një pasaktësi formale që nuk ndikon në parametrat teknikë të produktit të ofruar dhe se Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar të kërkojë sqarim në përputhje me nenin 72 të LPP-së para se të marrë vendim për eliminim.

Ndërsa për pozicionin 3 në kuadër të Pjesës C, OE ankues pretendon se Autoriteti Kontraktues ka interpretuar në mënyrë të gabuar kërkesën teknike “Set koke kaçavide L25 mm – 32 pjesë”, duke konsideruar se të gjitha pjesët e setit duhet të jenë vetëm koka kaçavide, ndonëse një kërkesë e tillë nuk është përcaktuar në Dosjen e Tenderit.

Përgjigje në pretendimin ankimor lidhur me Pjesën A: Pozicionet 18, 19, 24, 25, 26, 27 dhe 28

Operatori ekonomik ankues pretendon se është eliminuar padrejtësisht për pozicionet 18, 19, 24, 25, 26, 27 dhe 28, me arsyetimin se nuk ka ofruar paketimin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues në përputhje me prodhuesin, përkatësisht se ka paraqitur vetëm fotografi të artikujve dhe jo edhe paketimin.

Nga analiza e Specifikimeve Teknike të hartuara nga Autoriteti Kontraktues rezulton se për pozicionet 18 dhe 19 kërkesa është formuluar si:

“Vida 3.5x9.5 të rrafshta (1000)” – Njësia: Kuti

“Vida 3.9x22 të rrafshta (1000) 16000” – Njësia: Kuti

Megjithatë, në Dosjen e Tenderit nuk është përcaktuar përmbajtja e njësisë së furnizimit (kutisë), përkatësisht nuk është specifikuar se një kuti duhet të përmbajë 1000 copë.

Në veçanti, për pozicionin 19, përshkrimi teknik përmban dy vlera numerike – “(1000)” dhe “16000” – pa u sqaruar në Dosjen e Tenderit se cilës karakteristikë teknike i referohet secila prej tyre, përkatësisht nëse ndonjëra nga këto i referohet paketimit për njësi furnizimi apo sasisë totale të kërkuar për artikullin në fjalë.

Ndryshe nga pozicionet tjera të kësaj pjese, ku Autoriteti Kontraktues ka përdorur formulim të qartë lidhur me paketimin, si p.sh. “(kuti prej 100 copë)” apo “në paketim 1000 copë”, për pozicionet 18 dhe 19 një specifikim i tillë mungon. Vendosija e numrit në kllapa në përshkrimin e artikullit, pa u lidhur në mënyrë të qartë me njësinë e matjes (“Kuti”), nuk përbën kërkesë të mjaftueshme teknike për konfigurimin e paketimit.

Ndërsa për pozicionet 24, 25, 26, 27 dhe 28, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që produktet të furnizohen në paketim të caktuar (1000 copë, 500 copë, 100 copë dhe 150 copë), megjithatë në Dosjen e Tenderit nuk është kërkuar që operatorët ekonomikë të dorëzojnë dëshmi nga prodhuesi lidhur me paketimin e produktit të ofruar.

Rrjedhimisht, eliminimi i OE ankues me arsyetimin se nuk është dëshmuar paketimi në përputhje me prodhuesin nuk mbështetet në një kërkesë të shpallur në Dosjen e Tenderit dhe përbën interpretim të specifikimeve teknike gjatë fazës së evaluimit, në kundërshtim me parimet e transparencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë të përcaktuara në nenin 7 të LPP-së. Në këto rrethana, pretendimi i OE ankues për pozicionet 18, 19, 24, 25, 26, 27 dhe 28 konsiderohet i bazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor lidhur me Pjesën B: Pozicionet 6, 12 dhe 13

Operatori ekonomik ankues pretendon se eliminimi i tij për pozicionet 6, 12 dhe 13 është bërë padrejtësisht, me arsyetimin se nuk ka përmbushur kërkesat teknike të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Nga analiza e dokumentacionit të ofertës rezulton se për pozicionin 6 (Burgji metalik HSS-G Ø14.0 mm) në listën e çmimeve është deklaruar prodhuesi Yato – Poloni, ndërsa në arsyetimin e eliminimit Autoriteti Kontraktues ka konstatuar se në katalogun e dorëzuar është paraqitur produkt i prodhuesit Hugo, duke e konsideruar këtë si mospërputhje ndërmjet prodhuesit të deklaruar dhe atij të ofruar.

Megjithatë, nga analiza e katalogut të dorëzuar nga OE ankues për këtë pozicion rezulton se në përshkrimin teknik të produktit janë paraqitur vetëm karakteristikat teknike të tij, ndërsa nuk është identifikuar prodhuesi përkatës i produktit të ofruar, përkatësisht nuk është paraqitur emër, logo apo ndonjë referencë teknike që e lidh produktin me një prodhues të caktuar.

Në këto rrethana, nga dokumentacioni i dorëzuar nuk mund të konstatohet se produkti i ofruar është i prodhuesit Hugo, siç është pretenduar nga Autoriteti Kontraktues në arsyetimin e eliminimit.

Sa i përket pozicioneve 12 dhe 13 (Popnitne 4x8 dhe 4x10), në Specifikimet Teknike është kërkuar furnizimi me produkte në paketim prej 100 copë, mirëpo në Dosjen e Tenderit nuk është kërkuar që operatorët ekonomikë të dorëzojnë dëshmi nga prodhuesi lidhur me paketimin e produktit të ofruar.

Rrjedhimisht, eliminimi i OE ankues me arsyetimin se nuk është dëshmuar paketimi në përputhje me prodhuesin nuk mbështetet në një kërkesë të shpallur në Dosjen e Tenderit dhe përbën interpretim të specifikimeve teknike gjatë fazës së evaluimit, në kundërshtim me parimet e transparencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë të përcaktuara në nenin 7 të LPP-së. Në këto rrethana, pretendimi i OE ankues për pozicionet 6, 12 dhe 13 konsiderohet i bazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor lidhur me Pjesën C: Pozicioni 3 – Set koke kaçavide L25 mm, 32 pjesë

Operatori ekonomik ankues pretendon se eliminimi i tij për pozicionin 3 është bërë padrejtësisht, me arsyetimin se seti i ofruar përmban gjithsej 32 pjesë dhe si i tillë përmbush kërkesën teknike të përcaktuar në Dosjen e Tenderit.

Nga analiza e Specifikimeve Teknike rezulton se për këtë pozicion është kërkuar furnizimi me “Set koke kaçavide L25 mm – 32 pjesë”.

Nga broshura e dorëzuar nga OE ankues rezulton se produkti i ofruar është “Set Kaçavidash Profesionale – 32 pjesë”, i cili përfshin jo vetëm koka kaçavide (bita), por edhe mjete dhe aksesori të tjerë funksionalë, siç janë doreza dhe mbajtëset.

Në këtë kontekst, OE ka ofruar një set kaçavidash që përmban komponentë të ndryshëm, ndërsa në Specifikimet Teknike është kërkuar furnizimi me set me koka kaçavide.

Rrjedhimisht, produkti i ofruar nuk përputhet me llojin e produktit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktues, andaj eliminimi i OE ankues për këtë pozicion konsiderohet i bazuar në nenin 59 të LPP-së. Në këto rrethana, pretendimi i OE ankues për pozicionin 3 nuk është i bazuar .

Përgjigje në pretendimin ankimor lidhur me nenin 108/A të LPP-së

Sa i përket pretendimit të OE ankues se Autoriteti Kontraktues nuk ka bërë shqyrtim meritore të kërkesës për rishqyrtim në kundërshtim me nenin 108/A të LPP-së, duke përsëritur arsyetimin e eliminimit fillestar pa trajtuar në mënyrë të argumentuar pretendimet e paraqitura nga ana e OE-së, nga analiza e Vendimit mbi Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim rezulton se Autoriteti Kontraktues ka trajtuar pretendimet e OE ankues në raport me arsyet e eliminimit për pozicionet përkatëse.

Në vendimin e tij mbi kërkesën për rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues ka dhënë arsyetim lidhur me konstatimet e bëra gjatë fazës së vlerësimit dhe ka adresuar pretendimet e paraqitura nga OE ankues.

Rrjedhimisht, nuk mund të konstatohet se Autoriteti Kontraktues ka dështuar të bëjë shqyrtim meritore të kërkesës për rishqyrtim në kuptim të nenit 108/A të LPP-së. Në këto rrethana, pretendimi i OE ankues lidhur me këtë pikë nuk është i bazuar .

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen

dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrësat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE " EKO - ELECTRONICS " SH.P.K. Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Raporti i ekspertit shqyrtues ka vlersuar se pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE " EKO - ELECTRONICS " SH.P.K., janë pjesërisht të bazuara.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara, të paraqitura ndaj vendimit të autoritetit kontraktues, për aktivitetin e prokurimit. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimit dhe rekomandimit në raportin e ekspertit shqyrtues. Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimit ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit ekonomik duhet të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe mbet në fuqi, Njoftimi mbi Vendimin e Autoriteti kontraktues, për anulimin e aktivitetit prokurimit me titull "Furnizim me Material Metalik - Ritender I", me numër të prokurimit 214/30400-25-11090-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues-Policia e Kosovës.

Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar, Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, i dates 29.01.2026, AK/Policia e Kosovës, me të cilin ka anuluar aktivitetin e prokurimit, "Furnizim me Material Metalik - Ritender I", me numër të prokurimit 214/30400-25-11090-1-2-1.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar pa vërejtje nga ana e këtij Paneli. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportet e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime të drejta po ashtu edhe lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli mbështet vlersimet e ekspertit shqyrtues me rekomandim, të cilët kanë shpjeguar në raportin e ekspertizës së tij me numër; 2026/0095, se gjatë zhvillimit të kësaj procedurë të prokurimit, autoriteti kontraktues ka zbatuar , dispozitat ligjore të LPP-së.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj" lidhur me nenin 59,1 cituar "Autoriteti kontraktues do të themeloi një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës"

Paneli shqyrtues bazuar në faktin aprovimit të pjeserishem te ankeses të OE " EKO - ELECTRONICS " SH.P.K, vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - POLICIA E KOSOVËS**
- **OE - " EKO - ELECTRONICS " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: